

Dizajno! Konkurrencë për bërje të Llogos



ERA ju fton që të merrni pjesë në garen/konkursin për projektimin e llogos së 'Qendres për Edukim të Qëndrueshëm pyjor' në Mullirin e Haxhi Zekës.

Çfarë është ERA?

'Environmentally Responsible Action (ERA) group' është një OJQ lokale mjedisore e vendosur në Pejë, Kosovë. ERA synon të nxisë dhe të rrit rendësinë e mjedisit, ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë në mesin e të vegjëlve, të rinjve dhe për vizitorët e Kosovës me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë natyrore dhe kulturore të rajonit si dhe të ofroj zgjidhje për zhvillim të qëndrueshëm.

Për të mësuar më shumë rreth ERA dhe aktivitetet e saj vizito www.eradirect.org, ose ERA në www.facebook.com/eragroup.

Çfarë është Qendra Edukuese për Male të qendrueshme?

Në janar të vitit 2011 ERA nisi një projekt i cili quhej "Zhvillimi i Qëndrueshëm i Alpeve në Kosovë përmes zhvillimit të shoqërisë civile, Qendra për Edukimin e Qendrueshëm malor dhe iniciativa rurale, si shtesë në projektet e SNV-s për të forcuar sektorin privat dhe atë të decentralizuar të pyjeve, e cila ishte e financuar nga agjensioni suedez për zhvillim ndërkombëtar, SIDA. Në këtë projekt, ERA do të bëjë hapjen e Qendres për Edukim të Qëndrueshëm pyjor në Mullirin e Haxhi Zekës e cila do të shërbejë si një qendër për edukime të ndryshme mjedisore dhe aktivitete në natyrë për të rinjtë. Hapja e qendrës do të bëhet në qershor 2011.

Çfarë është ajo mbi të gjitha?

Qëllimi i kësaj gare është të promovojë pjesëmarrjen e të rinjve aktivë në shoqëri, me qëllim të krijimit të një **llogo**-je për programin e ri ERA Grupit, më sakt për: 'Qendren për Edukim të Qëndrueshëm pyjor'. Ne duam të inkurajojmë të rinjtë, të jeni pjesë - kështu që edhe ju - për të kontribuar për shoqërinë nëpërmjet pjesëmarrjes aktive, për të jetuar një jetë aktive në natyrë dhe të jeni të përfshirë në çështjet e mjedisit. Përmes aktiviteteve tona, ne gjithashtu duam të japim një mundësi për të gjithë njerëzit aktivë të rinj për të shprehur idetë e tyre dhe të krijimtarisë! Dhe për të promovuar se janë shumë mënyra të ndryshme për të qenë aktiv dhe për të marrur pjesë.

Llogo duhet të jetë:

Dezajn i fjalëve: "Sustainable Mountains Education Center";

- të reflektoj vlerat thelbësore të ERA-s, natyrën dhe aktivitetet e qendres për mjedisin
- një ngjyrë;
- dizajn të thjeshtë;
- aftësinë për të përdorur në forma të ndryshme, p.sh. website pulla, broshura

Çmimi i parë: 150 €

Llogo fituese do të jetë ajo që do të duket më e përdorshme në broshura, website, publikimet dhe ngjarjet e Qendres Edukuese për Male të Qendrueshme.

E rëndësishme!

Grupi i ERA ka të drejtën e përdorimit dhe riprodhimit të gjithë materialeve të cilat do të wërdoren në këtë garë/konkurs. Llogo mund të wërdoret nga grupi ERA në botimet e shtypura, raporte, broshura e programe të tjera, etj. Organizatorët e konkursit dhe bordi i zgjedhur rezervojnë të drejtën për të eliminuar të gjitha veprat e pa nënshkruara, vepra të cilat do të reflektojnë apo provokojnë jotolerancë, diskriminim, që përmbajnë ndonjë mesazh tjetër negativ që nuk pasqyrojnë vlerat thelbësore të grupit ERA.

Kush mund të marrë pjesë?

Të gjithë Ju. Konkursi është i hapur për të gjithë.

Çdo person është i lejuar që të dorëzoj deri në tri (3) llogj aplikacione (versione).

Ju lutem dërgoni punën tuaj **në-format jpeg** së bashku me **formularin e pjesëmarrjes** ne e-mail (shih me poshtë).

Aplikacionet pa formularin e pjesëmarrjes nuk do të merren parasysh. Çdo llogj duhet të ketë emrin e plotë të autorit/s, (nëse dorëzoni më shumë se një foto, thjesht shtoj 1, 2, 3).

Aplikacionet në. jpeg format i dërgoni në: elina.a.savolainen@gmail.com nga dita e premte 29 prill 2011.

Titulli i E-mail: Aplikacion në Konkursin për llogj

Stafi i ERA-s do të vlerësojë veprat dhe të zgjedh fituesin.

PARTICIPATION FORM

Emri		Mbiemri	
Data e lindjes		Gjinia	
Adresa		Kombësia	
E-mail		Nr. i telefonit	

Do të dëshironit të jeni i shtuar në listën e anëtarve të grupit ERA për t'u informuar për aktivitetet dhe mundësitë në ERA?

Unë/Ne vërtetojmë se puna e paraqitur është e imja/jona, unë/ne do ta lejoj/më që ajo të jetë publikuar dhe të përdoret nga 'Environmentally Responsible Action (ERA) group'.

Unë/Ne vërtetojmë se kjo punë nuk ka qenë kurrë e dorëzuar në ndonjë konkurs tjetër më herët.
Unë/Ne vërtetojmë se materiali i paraqitur nuk ka thyer ligjin e privatësisë apo të drejtën e autorit.
Unë/Ne pranojmë se materiali dorëzuar bëhet pronë e grupit ERA dhe mund të përdoret dhe të riprodhohet pa lejen time/tonë të veçantë.

Unë/Ne pranojmë se organizatorët e konkursit dhe bordi i zgjedhur kanë të drejtë për të eliminuar të gjitha veprat e panënshkuara dhe vepra të cilat do të reflektojnë në ndonjë mënyrë diskriminim, jotolerancë, ose përmban ndonjë mesazh të tjetër negativ.

Signature

Place, date